



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Adresa:Fushe-Arrez,Prefektura Shkoder,Tel:027123131,Email:info@bashkiaushearrez.gov.al

Fushe-Arrez me, 08/ 08/2023

Procesverbal -Tipi i kontrates - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS - “Rindertim i mureve mbajtes te shesheve te pallatve ne
Qytetin Fushe-Arrez”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45262620-3 Mure mbeshtetes

VLERA E FONDIT LIMIT – 28 510 190 (njetzet e tete million e peseqind e dhjete mije e njeqind e dhjete) **leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrez**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) **Kopjet e çertifikuara të bilanceve për vitet 2020,2021 dhe 2022** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse e të konfirmuara nga ky autoritet.
- b) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitin **2022**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. 160/2020 “Per prokurimin publik” neni 77, pika 3, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 43 pika 4., sipas shtojces 7 pika 1 germa dh tek DST.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

- a- Në lidhje me përvojën e mëparëshme të ofertuesit, kërkohet dëshmi për punë të së njëjtës natyre në një vlerë 50% të fondit limit për të cilin konkurrohet, të realizuara nga operatori ekonomik në një nga pese vitet e fundit,ose
- b- Kontrata të ngjashme me punime të së njëjtës natyrë ku vlera totale e punës së pese viteve të fundit është të paktën sa dyfishi i fondit limit.

Plotësimi i një prej kushteve të sipër përmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

-Për të vërtetuar përvojën e mëparshme nga OE duhet të paraqiten:

a- si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohet vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlerat, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmdushjen e suksesshme të punëve .

b- në rasin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat , kërkohet si dëshmi , për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe cdo lloj dokumenti tjetër, që parshkohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 39 pika 5. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës..

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme :

NP-1 A

NP-4 A

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licencat e mëposhtme:

NS-1 A

NS-18 A

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.neni 39 pika 6 germa a.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
N.P – 1 A	Punime Germimi	Percaktimet ne preventiv	A

N.P - 4 A	(Punime ne rruge pavaresisht karakterit qe jane)	Percaktimet ne preventiv	A
N.S – 1 A	(Punime për prishjen e ndërtimeve).	Percaktimet ne preventiv	A
N.S – 18 A	(Punime topogjeodezike).	Percaktimet ne preventiv	A

2.3.3 Një punësim mesatar i të paktën **20 (njetzet)** personave të siguruar për periudhën **Korrik 2022- Dhjetor 2022**. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj dhe listepagesat e shoqërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39 pika 6 germa ç. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar stafin inxhinierik me kontratë pune të vlefshme, diplomë, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, si më poshtë:

- Ing. Ndërtimi **1** (nje)
- Ing. Gjeodet **1** (një)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, pika 4, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39 pika 6 germa c. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Është kërkuar inxhinier ndërtimi i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet, për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit të punimeve të betonit të pranishme në preventiv si: ndërtim mure betoni, pusetat beton arme, puseta shpërndarje dhe pusetat e kontrollit, breza, themele etj.

Është kërkuar gjeodet/topograf, pasi sipas relacionit teknik dhe specifikimeve teknike, është parashikuar se kontraktori që do të marrë përsipër zbatimin e objektit inxhinierik, duhet të bëjë dendësimin e pikave të bazamentit, duke realizuar vlerat e paracaktuara të dhëna në specifikimet teknike të objektit, në lidhje me saktësinë e realizimit të piktimit. Nga shoqëria kërkohet dhe një azhurnim i saktë i këtij investimi në përfundim.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, nga të cilët te pakten:

- Karpentire **3 (tre)**
- Hekurkthyes **2 (dy)**
- Specialist Ndertimi **1 (nje)**
- Pllakashtrues **1 (nje)**

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht **2 (dy) manovratorë** të mjeteve të rënda, dhe **2 (dy) drejtues mjetes**, te pajisur kontrata pune dhe me dëshmite perkatëse dhe te jete ne listepagesat e shoqerise.
- Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar 5 punetore te thjeshte dhe te figuroje ne liste-pagesat e shoqerise .

Për këto punonjës duhet të paraqitet dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse, kartela personale të sigurimit teknik IQT ose ekuivalente si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjim nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, pika 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39 pika 6 germa c. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për të përmbushur me sukses kontratën.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar. Stafin teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

2.3.6 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamione vetëshkarkues, kapaciteti total mbajtës minimumi 27 ton	në pronesi ose me qera	copë	1
2	Kamion vetëshkarkues me kap mbajtës 5 - 7 ton	në pronesi ose me qera	copë	1
3	Kamion vetëshkarkues me kap mbajtës 3 - 5 ton	në pronesi ose me qera	copë	1
5	Kamionçine 1-2 Ton	në pronesi ose me qera	copë	1
6	Kamion me vinç	në pronesi ose me qera	copë	1
7	Autobetoniere vetengarkuese mbi 3.5 m3	në pronesi ose me qera	copë	1
8	Fadromë me goma tip eskavator 0.25m3/me zinxhir me veshje te gomuar	në pronesi ose me qera	copë	1
10	Minieskavator	në pronesi ose me qera	copë	1
14	Motogjeneratorë	në pronesi ose me qera	copë	1
15	Betoniere dore	në pronesi ose me qera	copë	2
16	Vibrator betoni	në pronesi ose me qera	copë	2
18	Matrapik dore	në pronesi ose me qera	copë	1
20	Rrezervuar uji minimumi 2000 l	në pronesi ose me qera	copë	1

21	Betoforma metalike/druri	në pronesi ose me qera	m2	300
22	Skeleri metalike	në pronesi ose me qera	m2	100
23	Lende druri e sharruar(binare)	në pronesi ose me qera	m3	4

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier" i ndryshuar, si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 20 copë
- Jeleke Fosfoeshente minimumi 20 copë
- Prozhektorë ndriçimi minimumi 3 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 1 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qera dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarinimin për disponimin e makinerive (sipas shtojcës 9) .

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se: makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 39 pika 6 germa d.

Per makinerit dhe pajisjet jemi referuar preventivit te punimeve, zerave perkates te tyre, karakterit te tyre, terren ku do te kryhen punimet. Fakti qe punimet do te realizohen ne zona te banuara eshte menduar qe ne disa pjese te projektit te perdoren edhe mjete te thjeshta dore, si betoniere dhe matrapik. Terreni lejon qe hedhja e betonave te behet nga pozicione te ndryshme. Eshte plnifikuar pranija e pajisjes motogjenerator pasi eshte e pamundur perdorimi i rrjetit elektrik ekzistues pasi nevoiten kontrata te vecanta dhe e kemi gjykuar me te nevojshem pranine e kesaj pajisje. Per rastin e rezurvarit te ujit e kemi gjykuar te domosdoshem per shkak se furnizimi me uje eshte me orare dhe OE dueht te siguroje rezerva te ujit me burime te tija. Mjeti kamion me vinc eshte gjykuar si i domosdoshem per procese si ngarkim shkarkim, transport i lendeve te thara te ndertimit.Per rastin e kamionave te llojeve te ndryshme eshte menduar domosdoshmeria e tyre per shkak se kemi te bejme me lloje te ndryshme transporti sidomos te inerteve te cilat do te perdoren sipas rastit ne terriore me mundesi levizshmerie te ulet, kjo per shkak te pozicionit ku do te rindertohen muret.

Per rastin e betoformave i lihet ne dore OE mjafton qe punimet te behen cilesore dhe estetikisht te bukura.

Per pajisjet identifikuese eshte gjykuar e nevojshme pranija e tyre per shkak se punimet do te realizohen ne qendra te banuara ku ka qarkullim te mjeteve.

2.3.7 Kandidati ofertues duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim .
- **OHSAS 18001:2007** ose **45001:2018** mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë” lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim .
- **ISO 14001:2018** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.160, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 44 pika 3.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se: operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate, në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime.

Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarde të cilësisë e cila mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësitë, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj.

Certifikatë ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

2.3.8 Operatorit Ekonomik duhet te deklaroje qe nepermjet ofertes se tij te garantoje zhvillimin e projektit duke plotesuar specifikimet teknike, kushtet e kontratës, si dhe te dhenat e tjera ne

dokumentat e tenderit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.